



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:271389

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05508877

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.1064/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me bashkëpunëtoreshen profesionale Teuta Spahija, në çështjen penale kundër të pandehurit K. K. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 e lidhur me nën par. 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1893/22 të datës 12.12.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 05.03.2024 në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit K. K., me datë 05.03.2024 shpalli ndërsa me date 27.03.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

K. K., i biri Sh. dhe nënës V. e gjinisë R. , i lindur me .... në Pejë, ku edhe jeton, rr “W.C.” nr-26, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor i qeramikave, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me dt 10.07.2022, rreth orës 10:46 minuta, në Pejë, në rr “N. T.” në lokalit “B.-C.”, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit V. S., në atë mënyrë që pasi i pandehuri ishte sulmuar fizikisht nga këtu i dëmtuari, gjatë përleshjes të njëjtit dalin jashtë lokalit, ku i pandehuri

më pas e sulmon fizikisht të dëmtuarin V. duke e goditur një herë me grusht në pjesën e kokës, ku si pasojë e kësaj të njëjtit i shkakton ndrydhje-kontusion të fytyrës, gërvishtje në regjionin e hundës dhe nënsyrit të majtë dhe ajtje të fytyrës, të cilat si të tilla kualifikohen në lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet,

- me çka ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 e lidhur me nën par. 1.4 të KPRK-së,

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

## GJYKON

Të pandehurit K. K. i shqipton:

I. DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 500 (pesëqind ) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

II. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 euro ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

III. I dëmtuari udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

## ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 12.12.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1893/22, kundër të pandehurit K. K. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 e lidhur me nën par. 1.4 të KPRK-së.

Fillimisht kjo lëndë sipas akuzës bazë është iniciuar kundër dy personave dhe atë të pandehurit V. S. dhe të pandehurit K. K., mirëpo i pandehuri V. S. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet në aktakuzë ku më pas gjykata e veçon procedurën penale konform nenit 242 par.8, pika 2 të KPPRK-së, dhe ndaj të pandehurit K. K. vazhdohet me shqiptimin e sanksionit penal, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 e lidhur me nën par. 1.4 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 05.03.2024, e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku dhe i pandehuri K. K. në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së, gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi “Duke marr parasysh se këtu i akuzuari K. K., e pranoj fajësinë konfor kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, nga se pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë vullnetare, pa ndikim dhe në mbështetje të fakteve të çështjes që përmban aktakuza, nga Gjykata kërkoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethana lehtësuese”.

I dëmtuari V. S. deklaroi “Unë pres që gjykata të vendosi në drejtim timin, ky më ka borgj mu 1000 euro, se ma ka lënë banjën në shpi të pakryer në gjysmë mi ka lonë qeramikat, dhe sherri i tij nuk po mundemi me hy në shpi të re, ky borxh ka qenë para se me ndodhë rasti – konflikti, ky o ardh dite e dasmës së vëllait me zori i pitë, dhe ka dashtë me i qit qeramikat, ky borxh mu më ka dhe pa mi jep paret nuk pajtohem me to”.

I pandehuri K. K. deklaroi “Nuk janë të vërteta ato çka i tha i dëmtuari, përveç se dy qoshet e derëtarëve të banjos që kanë qenë të papërfunduara, pjesa tjetër ka qene e përfunduar, ndërkaq 300 euro më kanë mbetur borxh, dhe më kanë thonë kur ti kryesh punët i merr paret e unë kur

kam shkuar nuk e kam ditë se a kanë darsëm apo nuk kanë, ndërsa për 300 euro më ka thonë vëllai i tij po ti japi paret e punën e kryen kur të mundesh nuk ka problem, edhe me vëllain e tij kemi pas një keqkuptim sa i përket këtij rasti, më vjen shumë keq për këtë rast që ka ndodhë, sepse ne njihemi edhe familjarisht dhe akoma jam i gatshëm me e përfundua atë punë, edhe ky nëse nuk doni unë me ja përfundua unë e dërgoj një mjeshtër tjetër me ja kryer punën”.

#### B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të pandehurit vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë prej 500 (pesëqind ) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin rrethana rënduese gjykata nuk gjeti, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimin të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 43 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin më gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së vendosi që të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shprehin gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me

qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata vendosi që të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest të rregullt civil, e kjo duke u bazuar në nenin 462 par.2 të KPPK-së.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1064/22, me datë 20.03.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale:

Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:

Leon Përlaska

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.